REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës:	2021:114853
Datë:	13.06.2022
Numri i dosjes:	2021:114854

C.nr.1377/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,Departamenti i Përgjithshëm,Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu**,**në çështjen kontestuese të paditëses H.K,nga Ferizaji,me numër personal të letërnjoftimit .... ,të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson av.Besmir Rrahmani ,nga Ferizaj, rruga"Sali Çeku" , kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj ,rruga "Ramadan Rexhepi"p.n-Ferizaj 70000 ,baza juridike :Kompenzim i pagës jubilare , me datë 13.06.2022 mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I.APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses H.K nga Ferizaji dhe **DETYROHET** e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj që paditëses H.K në emër të një page jubilare për 10 vite përvojë pune tia paguaj shumën prej 399.68 euro me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë 09.06.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Detyrohet e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj që paditëses H.K në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tua paguaj shumat siq vijon:për përpilim të padisë shumën prej 78 euro,për përfaqësim në dy seanca gjyqësore shumën prej 202.80 euro,për taksën gjyqësore shumën prej 21 euro ,të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja H.K, ka parashtruar padi në këtë Gjykatë,kundër të padituërs Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare,me bazë juridike :kompensim i pagave jubilare.

Nga thëniet e paditëses në padi rezulton se e njëjta padinë e bazon në faktet e theksuara:paditësja H.K ka qenë punëtore shëndetësor-anëtare e FSSHK-së ,në kuadër të QKMF-Ferizaj ,institucion shëndetësor ky që është nën administrimin e të padituërs .Paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura e sistemuar në punët dhe detyrat e punës në QKMF-Ferizaj ,me mbi 10 vite përvojë pune.E njëjta duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale,konkretisht nenin 17 paragrafi 3 ,ka fituar të drejtën për marrjen e pagave jubilare andaj ju ka drejtuar me kërkesë të padituërs për përmbushje të obligimeve .E paditura nuk i është përgjigjur kërkesës së paditëses dhe nuk i ka kompensuar deri më sot pagat jubilare në cilësinë e punëdhënësit të fundit.Paditësja para se të parashtrojë këtë padi ,ka provuar që çështjen objekt kontesti ta zgjidhë në procedurë administrative ,por edhe pas përpjekjeve të bëra ,e paditura asnjëherë nuk ka shfaqur gatishmërinë për ta zgjidhur këtë çështje ,andaj duke u mbështetur në të gjitha këto i propozohet gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar.

Përfaqësuesi i paditëses av.Besmir Rrahmani,në seancë gjyqësore ka deklaruar :mbesim pranë padisë dhe kërkesë padisë dhe thënieve nga seancat e kaluara ,duke shtuar se paditësja H.K ,sipas listës së pagave ,ka mbi 15 vite përvojë pune në kuadër të Qendrës Kryesore Familjare dhe në bazë të kësaj ka fituar të drejtën për kompensimit në një pagë jubilare mbi 10 vite përvojë pune.Kërkojmë nga gjykata që për një pagë jubilare mbi 10 vite përvojë pune , paditëses të ia paguajnë shumën prej 399.68 euro me kamatë ligjore prej 8% nga dita e

parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive ,e po ashtu të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë :për përpilim të padisë shumën prej 78 euro si dhe për përfaqësim në dy seanca gjyqësore shumat nga 101.40 euro .gjithësej 202.80 euro ,taksën gjyqësore shumën prej 21 euro,total vlerën prej 301.80 euro.

E paditura Komuna e Ferizajit-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në përgjigje në padi lidhur me çështjen kontestuese përmes të autorizuarit të saj e përfaqëson Agim Rexhaj ka deklaruar :paditësi ka ushtruar padi kundër të padituresë në Gjykatën Themelore në Ferizaj ,për kompensimin e shpërblimeve jubilare ,por nuk ka ushtruar asnjë ankesë te e paditura për këtë çështje ,edhe pse ekziston Komisioni i Ankesave.Me ligjin e punës nr.03/L-212 nuk është paraparë kompensimi për shpërblim jubilar.Sipas nenit 90 pika 5 e Ligjit të Punës thuhet se zbatimi i një "Marrëveshje Kolektive vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punonjës të tyre të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen kolektive"që do të thotë QKMF-ja nuk është nënshkruese e marrëveshjes në të cilën bazohet padia e paditësit.Sa i përket shpërblimit për paga jubilare QKMF nuk mund të bëjë kompensimin e këtyre kërkesave sepse Qeveria e Republikës së Kosovës pas marrëveshjes ka qenë e obliguar që ta ndajë buxhetin për implementimin e kësaj kontrate dhe në mungesë buxheti për këto pagesa e paditura QKMF nuk ka mundur të bëjë përmbushjen e këtyre kërkesave. Andaj duke u nisur nga të gjitha këto ,i propozohet gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

E paditura nëpërmjet të autorizuarit të saj Agim Rexhaj,në seancë gjyqësore ka deklaruar :e kundërshtoj padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ,për arsye se e njëjta është në kundërshtim me kontratën kolektive sektoriale si dhe mbetem në tërësi në kërkesën që të dëgjohet në cilësi të palës H.K dhe e njëjta të deklarohet lidhur me autorizimin e dhënë avokatit. Besoj fuqishëm që kjo gjykatë do ti vlerësoj drejtë provat dhe thëniet tona gjatë procedurës dhe e njëjta të vendos në favor të të padituresë .

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civile juridike janë administruar si provë: kontrata e punës për kohë të pa caktuar e dt.01.07.2013,ankesa e dt.18.12.2020,kërkesa e dt.09.11.2020,dy lista të pagave ,aktvendimi i

dt.14.04.2016,me nr.379 i lëshuar nga e paditura,aktvendimi i dt.20.05.2021,nr.551 i lëshuar nga e paditura,aktvendimi i dt,02.06.2020 nr.375 i lëshuar nga e paditura,formulari i të dhënave për listën e pagave.

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar e dt.01.07.2013,gjykata ka vërtetuar se kjo kontratë është lidhur në mes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj të cilën e përfaqësonte drejtori Dr.Afrim Abazi(punëdhënësi) dhe H.K në cilësinë e punëmarrësit,ku titulli i punës ka qenë infermiere në QKMF-Ferizaj me pagë prej 290 euro.

Me leximin e ankesës së dt.18.12.2020,gjykata ka vërtetuar se H.K ka paraqitur ankesë kundër përgjigjes së dhënë nga ana e Drejtorisë së QKMF në Ferizaj si dhe ka kërkuar që ankesa e saj të aprovohet në tërësi si e bazuar,ashtu që ta detyroj të paditurën që paditëses H.K në emër të një page jubilare ta paguaj shumën prej 391.68 euro.

Me leximin e listës së pagave,gjykata ka vërtetuar se paga bruto e H.K ishte 449.15 euro,kurse paga neto është 399.68 euro,ndërsa përvoja e punës 15 vite.

Me leximin e aktvendimit i dt.14.04.2016,me nr.379 ,i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ,gjykata ka vërtetuar se në bazë të këtij vendimi H.K i është lejuar pushimi pa pagesë në kohëzgjatje prej 4 muajsh duke filluar prej dt.01.05.2016 deri më 31.08.2016.E njëjta duhet të lajmërohej në punë më dt.01.09.2016.

Me leximin e aktvendimit i dt.20.05.2021 ,me nr.551 ,i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ,gjykata ka vërtetuar se në bazë të këtij vendimi H.K i është lejuar pushimi pa pagesë në kohëzgjatje prej 6 muaj duke filluar prej dt.01.06.2021 deri më 31.12.2021 .E njëjta duhet të lajmërohej në punë më dt.01.01.2022.

Me leximin e aktvendimit i dt.02.06.2020,me nr.375 ,i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare,gjykata ka vërtetuar se në bazë të këtij vendimi H.K i është lejuar pushimi

pa pagesë në kohë zgjatje prej 5 muaj duke filluar prej dt.03.07.2020 deri më 30.11.2020 .E njëjta duhet të lajmërohej në punë me dt.01.12.2020.

Me leximin e formularit të të dhënave për listën e pagave ,gjykata ka vërtetuar se H.K ka ndërprerë vullnetarisht marrëdhënien e punës.

Ndërmjet palëve nuk është kontestuese se paditësja ishte punëtore e të padituës ,mirëpo është kontestuese edhe baza e kërkesë padisë por edhe lartësia e saj.

Me nenin 17 paragrafi 3 pika 1.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në fuqi nga data 11.06.2018 është parapar: Punëtorët Shëndetësorë në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi fundit për 10 vjetë të përvojës në punë në institucionet shëndetësore ,te punëdhënësi fundit në vlerë të një page mujore të tyre.

Kjo gjykatë duke u nisur nga dispozitat e sipër përmendura të Kontratës Kolektive Sektoriale, si dhe gjendjes faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si më lartë ,ka nxjerrur përfundim se është e bazuar kërkespadia e paditëses dhe nga kjo arsye edhe e ka detyruar te padituën që paditëses t'ia paguaj shumën si në pikën I, dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore e kërkesëpadisë së paditëses qëndron edhe në Ligjin për Mardhëniet e Detyrimeve, dispozitat përkatëse të këtij ligji që e rregullojnë materien e çështjes së kontratës,kurse konform nenit 8 të Ligjit për Mardhënjeve të Detyrimeve Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.

Kurse me nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së është paraparë Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe qëndrimin e të padituës e cila e ka kundërshtuar kërkesëpadin e paditësit ,përmes të autorizuarit të sajë në seancën e datës 10.05.2022 me

arsyetim se paditësja nuk është anëtare e sindikatës ,por këto theksime kjo gjykatën i quan të pa bazuara edhe atë nga këto arsye*: Nga përmbajtja* e nenit 17 të *Kontratës Kolektive Sektoriale rezulton se e njejta kontratë nuk parashef si kushtë për realizimin e shpërblimit jubilar antarësimin në sindikat .Kurse edhe nëse do të ekzistonte një dispozitë e tillë në Kontratën Kolektive Sektoriale e njejta nuk do të krijon efekte juridike ,sepse do të ishtë absolutishtë e pavlefshme dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore e të cilat janë:neni 3 paragrafi 1 pika 1.17,në lidhje me nenin 4 , dhe nenin 5 pragrafi 1 dhe 5 të gjitha këto dispozita të Ligjit të Punës.Neni 2 paragrafi 1 pika a ,neni 4 paragrafi 1 pika d të Gjitha këto dispozita të Ligjit për Diskriminimin Ligji Nr.2004/ 3,me të cilat dispozita ligjore ndalohet qfarëdo forme e diskriminimit,e që kjo nënkupton se anëtarët e sindikatës në pikpamje të realizimit të kompensimit për shpërblim jubilar nuk mund të kenë më shumë të drejta se sa punëtorët që nuk janë anëtarë të sindikatës*.

Kurse fakti se paditësja ka përvojën e nevojshme të punës për realizimin e shpërblimit jubilar vërtetohet pjesërsishtë edhe nga e paditura e cila në seancën e datës 10.05.2022 ,përmes të autorizuarit të sajë thekson se paditësja në QKMF ka punuar 13-14 vite. E që fakti i përvojës në fjalë të punës vërtetohet edhe nga lista e pagave.

Gjykata ka vlerësuar edhe thënjet e të autorizuarit të të paditurës i cili e konteston autorizimin e dhënë nga paditësja ,mirëpo këtyre thënjeve gjykata nuk ua fali besimin ,sepse nga autorizimin i datës 28.06.2021 ,i cili gjindet në shkresat e lëndës rezulton se autorzimi i dhënë përfaqësuesit të paditësit është i përpiluar në mënyrë të plotë dhe është në origjinal dhe përmban nënshkrimin e palës.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të Ligjit për Mardhënieve të Detyrimeve i Kosovës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Gjyqtari

Burim Emërllahu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.